

25.01.2022
Ora 12:11

RENDI I DITËS


Projektvendim “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. A. Agolli**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu) LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Fillojmë, në seancën e sotme në rend dite kemi këto çështje projektvendimin “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022” dhe pika e dytë ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e modelit dhe zarfave të sigurisë që do të përdoren në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të disa njësive vendore, të datës 6 Mars 2022”. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me projektaktin “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022”. Zoti sekretar, fjala për ju!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2022**

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 ka caktuar rregullat për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë për Komisionin e Qendrës së Votimit. Komisioni Rregullator me vendimin nr. 5, datë 19.02.2021 ka përcaktuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve prodhon vula rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së, të nxjerrë jashtë përdorimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përcakton numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi si dhe formatin, tekstin dhe numrin serial për çdo vulë rezervë. Referuar praktikave të deritanishme të mëparëshme dhe nga zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 u prodhuan 10% të vulave të të gjithë qendrave të votimit. Kemi parashikuar që trendin e prodhimit të vulave rezervë të zgjedhjeve të datës 25 Prill ta kemi dhe për këto zgjedhje. Nga 940 qendra votimi që janë në 6 bashkitë, të prodhojmë rreth 10% e tyre që do të thotë rreth 100 vula rezervë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Pyetje, diskutime përfaqësuesit e partive?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Jemi njohur me relacionin dhe projektvendimin që na është vendosur në dispozicion nga administrata e KQZ-së. Nuk kemi ndonjë kundërshti, apo objeksion në lidhje me këtë projektvendim dhe jemi dakord në parim!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Do doja në qoftë se mundeni zoti Celibashi, vetëm një kërkesë të karakterit të formës le të themi për sa i përket projektvendimeve që janë për t'u miratuar. Ne nuk kemi ndonjë kundërshtim. Siç tha dhe kolegu Logu, jemi njohur nëpërmjet komunikimit elektronik me to, por në qoftë se ka mundësi administrata e KQZ-së në këtë rast, në momentin e mbledhjeve të na verë në

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2022*

dispozicion një kopje të projektvendimit përkatës në tavolinë, në mënyrë që t'i kemi. Mund të ndodhë që të jemi jashtë zyrave tona dhe nuk e kemi fizikisht me vete.

Z. I. Celibashi: Po dakord, vetëm për efekt të printimit, por në rastin kur duhet mund ta printojmë dhe mund ta vendosim aty. Derisa ta zgjidhim në një mënyrë tjetër duke vendosur ndonjë terminal elektronik aty. Mirë, dakord miratohet projektvendimi sipas draftit të paraqitur!

Vendimi nr. 9

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e modelit dhe zarfave të sigurisë që do të përdoren në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të disa njësive vendore, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. A. Agolli**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu) LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e modelit dhe zarfave të sigurisë. Po, zoti sekretar!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 99, 118 dhe 119 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se si pjesë e procedurave është përdorimi i zarfeve specifike për adresimin e fletëve të votimit, gjatë vlerësimit dhe numërimit nga GNV-të, si dhe mbylljes në zarfa të veçantë të procesverbaleve të mbylljes së kutisë së votimit përpara procesit të votimit. Gjithashtu Kodi Zgjedhor neni 20, pika 5 e tij parashikon zarfe sigurie për fletët e votimit të hedhura gabim të ndara sipas llojit të organit për të cilin janë hedhur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të paisur komisionet përkatëse me zarfa sigurie duhet të miratojë modelin e çdo zarfi sigurie si dhe të marrë masa për prodhimin dhe dërgimin e tyre në çdo qendër votimi. Gjithashtu për të unifikuar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2022*

praktikën gjyqësore në zbatim të nenit 21, pika 2 të Kodit Zgjedhor, ka përgatitur modelet e zarfeve të sigurisë përmbajtjen dhe specifikimet e të cilave duhet të jenë bazuar në nenet e sipërcituara si dhe në eksperiencën e zgjedhjeve të mëparshme. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe modelet e dokumentacionit për të cilat referohet, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në lidhje me këtë projektakt?


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Jemi njohur me projektvendimin dhe relacionin në fjalë. Vlerësojmë që këto janë çështje të natyrës teknike-organizative për të cilën Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka tashmë gjithë eksperiencën e nevojshme. Nuk kemi ndonjë objeksion apo kundërshti. Jemi këtu siç e thashë në respekt të procesit dhe gjithë hapave proceduriale nga momenti i parë deri në momentin e fundit lidhur me këto zgjedhje, faleminderit!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Dhe ne zoti Celibashi jemi njohur me përmbajtjen e këtij akti, nuk kemi ndonjë kundërshtim. Mendojmë që akti duhet të miratohet sipas formatit që na është komunikuar.

Z. I. Celibashi: Faleminderit për sa thatë, meqenëse jeni dakord me përmbajtjen e këtij projektakti, e miratojmë atë sipas draftit të propozuar! Pikë tjetër në rendin e ditës?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk kemi!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit për kontributin edhe përfaqësuesve të partive politike, edhe përfaqësuesve të administratës! Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 10

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

